Screening per la prevenzione
del tumore del collo dell'utero

Përditësimi:
Tetor 2024

Screening për parandalimin e tumorit të qafës së mitrës: informacione të shkurtra për përdorueset

OSSERVATORIO
NAZIONALE
SCREENING

GISCi

Gruppo Italiano Screening del Cervicocarcinoma

Albanese
Shqipe

Çfarë është tumori i qafës së mitrës?
Është një tumor që ka mundësi të parandalohet dhe që shkaktohet nga disa lloje të papillomavirusit njerëzor (HPV).

Çfarë mund të bëjmë për të parandaluar tumorin e qafës së mitrës?
Mund të marrim pjesë në screening (analizën), që është një program pa pagesë për parandalimin e tumoreve për gratë e moshës nga 25 deri në 64 vjeç.
Nëse je më nga 25 deri në 29 vjeç, analiza screening është Pap-testi çdo 3 vjet.
Nëse je më nga 30 deri në 64 vjeç, analiza screening është testi për kërkimin e HPV-së çdo 5 vjet.

Si bëhen këto analiza?
Si për Pap-testin ashtu edhe për testin e HPV-së, obstetri ose mjeku marrin një sasi të vogël të materialit nga qafa e mitrës. Marrja e materialit është e thjeshtë, pa dhimbje dhe zgjat disa minuta.

Pse duhet t'i bëjmë këto analiza edhe në qoftë se jemi mirë me shëndet?
Sepse ky tumor dhe dëmtimet që e paraprijnë nuk japin shqetësime gjithmonë.
Testi screening jep mundësinë e parandalimit të tumorit të qafës së mitrës ose mundëson zbulimin e tij në fazën fillestare.

Çfarë është papillomavirusi i njeriut (HPV)?
HPV është një virus që shkakton një infeksion shumë të zakonshëm në popullatë, por në shumicën e grave ai zhduket spontanisht pas një ose dy vjetësh.
Në disa raste infeksioni vazhdon dhe mund të shkaktojë dëmtime, të cilat, nëse nuk kurohen, mund të shndërrohen dalëngadalë në një tumor.

Çfarë ndodh pasi të bëjmë testin screening?
Nëse testi screening është normal ose nuk parashikon thellime të menjëhershme, do ta merrni përgjigjen në shtëpi dhe do t'ju kërkohet të përsërisni testin në kohën e caktuar.
Nëse testi screening është anormal dhe kërkon thellime të mëtejshme, do të kontaktoheni direkt për një takim.

Sa duhet të paguaj?
Testet e kontrollit dhe i gjithë procesi i diagnostikimit dhe kurave janë pa pagesë.

Nëse bëj një screening a mund të jem e qetë?
Screening, nëse bëhet rregullisht dhe duke ndjekur udhëzimet sipas programit, është mjeti më efektiv për të parandaluar tumorin e qafës së mitrës.
Megjithatë, si çdo analizë, testet screening paraqesin disa limite e nuk mund të zbulojnë sëmundje të tjera gjinekologjike.

Për informacione të mëtejshme në lidhje me infeksionin nga papillomavirus dhe screening me test HPV, mund të konsultoni "Le 100 domande sull'HPV" (100 pyetje për HPV-në, në dispozicion në italisht) në faqen e internetit
www.osservatorionazionalescreening.it ose **www.gisci.it**

Grupi i punës

Anna Iossa e Francesca Maria Carozzi (Coordinatori), Angela Brachini, Cinzia Campari, Debora Canuti, Paola Capparucci, Francesca Maria Carozzi, Carmelina Di Pierro, Chiara Fedato, Grazia Grazzini, Anna Iossa, Gessica Martello, Cristina Nicolai, Antonella Pellegrini.

Falenderime të veçanta për ata që kontribuan në realizimin e këtij projekti:
Cloè Belliot, Lorena Baboçi, Magdalena Ciupercovici, Elise Merrill Chapin, Elena Dascaliuc, Ekaterina Egorchenkova, Anna Garasymiv, María Maestre Fernández, Wendy Martin, Eshraga Mohammed Abdalwahap, Meriem Moutiai, Julia Nico, Natascha Pleshca, Catalin Szabò, Cristofor Catalina Doina, Katrin Hoehn, Marco Casini.

Falë 100 pyetjeve për grupin e punës për HPV:
Debora Canuti, Francesca Maria Carozzi, Carla Cogo, Annarosa Del Mistro, Carmelina Di Pierro, Silvia Franceschi, Cristina Giambi, Paolo Giorgi Rossi, Anna Iossa, Tiziano Maggino, Gessica Martello, Maria Grazia Pascucci.

Botimi i parë: **dhjetor 2018**

Botimi i dytë: **tetor 2024**

Prodhim editorial:
Inferenze scarl, Milano

Përkthimi nga italishtja në gjuhë të tjera u krye nga:
STUDIO TRE S.r.l., Reggio Emilia

Paraqitja:
Inferenze scarl, Milano